



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 693645101

KONTRATA TË TJERA

Nr. repertori: 3340

Nr. koleksioni: 1441

Tirane më 24/04/2025



Ligjet referuese:

- Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

Akti notarial përbëhet nga 2 fletë



A2025051400119238262



EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J62903456H
2. Data e Regjistrimit	16/03/1993
3. Emri i Subjektit	GJIKURIA
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	27/02/1995
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/02/1995
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Njësia Bashkiake Nr. 2, rruga “Faik Konica”, residenca “Lion Park”, kati 3-të, Tiranë.
8. Kapitali	272.700.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Ndertim, montim dhe rikonstruksion i objekteve dhe veprave të çfareollojshme, industriale, turistike, civile. Asfaltim rrugesh, punime bonifikimi. Prodhim i materialeve të ndertimit, si dhe transport i tyre. Grumbullim, transportim, seleksionim te mbetjeve urbane dhe riciklim, perpunim, presim te mbetjeve te riciklueshme, kompostim te mbetjeve organike. Trajtimi i ujerave dha ujerave te zeza. Veprintari private ne fushen energjitetike, studim, projektim, ndertim, i Hidrocentraleve, dhe impjanteve te tjera per prodhimin e energjise elektrike. Shfrytezimi i tyre dhe prodhimi e tregtimit i energjisë elektrike. Ndertim i nenstacioneve elektrike, linjave elektrike te tensionit te larte dhe te mesem, kabinave te transformimit dhe rrjetete shperndares te tensionit te ulet si dhe linjave te telekomunikacionit. Tregtim i artikujve te ndryshem industrial, ushqimor, import-eksport etj, tregtim, instalim dhe sherbime te makinerive dhe pajisjeve elektronike, kompjuterike dhe informatike. Ofrime rrjetesh dhe sherbime te komunikimeve elektronike, ndertim i linjave me fibra optike. Zhvillim i aktivitetit ne fushen e programimit dhe mirembajtjes te software dhe platformave software. Ne fushen e ndertimit te rrjeteteve inxhinierike te ujesjellesit, te kanalizimeve te ujerave te bardha dhe te zeza, te vaditjes te kullimit, impiante te ndryshme, punime karpenterie, topogeodezike, punime ne siperfaqe te gjelberta, mirembajtje te rrugeve, ne fushen e mbrojtjes



ambientale lumore si dhe pastrimi i vijes bregdetare. Studim, projektim dhe zbatim punimesh ne hortikulture, arkitekture mjedisni, pejsazheve, siperfaqeve te gjelberta si lulishte, parqe dhe pyje, pastrimi i siperfaqeve urbane, mirmajtja dhe zhvillimi dekorit ne mjedise urbane. Prodhimi dhe tregtimi (materiali mbjelles bimor) i farnave, fidanave, luleve, shkurre e drureve dekorative. Kryerja e sherbimeve profesionale ne fushen e prerjes dhe mirembajtjes se pyjeve. Sherbime te ekspertizes dhe profesionale ne mjedis, pyje dhe kullota (studime, projekte dhe zbatime). Sherbimi dhe riparimi i automjeteve, hapje pike servisi. Studime dhe konsulence ne fushen e mjekesise. Te kryeje çdo aktivitet tregtar, financiar dhenie e marje me qera. Te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi. Aktivitet ne fushen e turizmit. Veprimitarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis. Karriere guri dekorativ. Sherbimi ekspertize dhe/ose profesionale te mbrojtjes civile. Sherbime ekspertize per, studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te çdo lloji. Hartimin e akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Te kryeje monitorime te gjendjes se mjedisit dhe komponenteve te saj si mjedis ujor, ajrin, biodiversitetin, pyjet dhe tokes. Te zhvilloje analiza laboratorike per matjen e parametrave te cilesise se ujerave siperfaqesore, ujit te pijshem, tokes dhe ajrit si dhe shkarkimeve te te gjitha llojeve te industries se mjedisit, te monitoroje parametrat mjedisore te qyteteve si ajri, zhurmat etj. Te jap konsulence ne fushen e mjedisit. Te hartoje dhe zbatoje projekte per trajtimin e ujerave te ndotura, industriale, ujrave bregdetare etj. Te ofroje konsulence ne fushen e GIS etj. Kryen sherbimet e desinfektimit, desinsektimit dhe deratizimit. Ofron sherbime ne implementimin e sistemeve ISO 14001,9001 etj. Ofron sherbime per Shendetin dhe Sigurine ne pune, te kurseve profesionale per implementimin e sistemit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune, ISO 14001 dhe ISO 9001. Te kryeje ndertime detare dhe punime thellimi ne uje. Transport mallrash per llogari te vet, per te trete dhe me qera brenda vendit. Transport te mallrave me mijete jashtë norme. Punime projektimi dhe zbatimi te restaurimit, perforcimit strukturor (retrofit) dhe koservim ne monumentet te arkitekturës, objekteve social kulturore, monumenteve te trashegimise kulturore, godinave an tike, rezidenciale me rendesi te vecante me vlera historike, objekteve te kultit. Konservim, restaurim e rikualifikim i rrrenoja e siteve arkeologjike, i arkitekturës se kultit, i arkitekturës se tradites (verninkulare), i

	hapesirave (rruge, sheshe) brenda qendrave historike, ansambleve historike urbane, mozaikeve, i pikturave murale dhe shkembore, i veprave te artit ne dru, allci, gure, qeramike, metal, qelq, tekstil, lekure, pergamen e telajo, etj.
10. Administratori/ët 10.1 Afati i emëritit	Milo Gjikuria Nga: 27/02/1995 Deri: 24/01/2029
11. Procedura e emëritit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administratoret do te jene se bashku per gjegjes per administrimin e Shoqerise. Perfaqesimi i shoqerise kundrejt paleve te treta ne marredhenie ligjore perfaqesimi si institucion shteterore/publike, institucion/subjekte private, banka, gjykata, etj duke nenshkuar cdo dokument te nevojshme me qellim perfaqesimin e shoqerise me pale te treta, ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe/ose te ligjit te zbatueshem, i perket Administratorit Florenc Gjikuria i cili vepron vçmas ne cdo rast. Administratori Florenc Gjikuria ka kompetencia te plota per te marre vendime te zakonshme dhe te jashtezakonshme per administrimin e Shoqerise, perveç kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligji(eve) te zbatueshme.
12. Administratori/ët 12.1 Afati i emëritit	Florenc Gjikuria Nga: 28/01/2005 Deri: 24/01/2029
13. Procedura e emëritit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administratoret do te jene se bashku per gjegjes per administrimin e Shoqerise. Perfaqesimi i shoqerise kundrejt paleve te treta ne marredhenie ligjore perfaqesimi si institucion shteterore/publike, institucion/subjekte private, banka, gjykata, etj duke nenshkuar cdo dokument te nevojshme me qellim perfaqesimin e shoqerise me pale te treta, ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe/ose te ligjit te zbatueshem, i perket Administratorit Florenc Gjikuria i cili vepron vçmas ne cdo rast. Administratori Florenc Gjikuria ka kompetencia te plota per te marre vendime te zakonshme dhe te jashtezakonshme per administrimin e Shoqerise, perveç kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligji(eve) te zbatueshme.
14. Ortakët 14.1 Vlera e kapitalit 14.2 Numri i pjesëve 14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	MiloGjikuria Para: 98.172.000,00 Natyre: 1,00 36,00



<p>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</p> <p>15. Ortakët</p> <p>15.1 Vlera e kapitalit</p> <p>15.2 Numri i pjesëve</p> <p>15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)</p> <p>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</p>	<table border="1"> <tr> <td colspan="2">FlorencGjikuria</td> </tr> <tr> <td>Para: 174.528.000,00</td><td>Natyre:</td></tr> <tr> <td>1,00</td><td></td></tr> <tr> <td>64,00</td><td></td></tr> </table>	FlorencGjikuria		Para: 174.528.000,00	Natyre:	1,00		64,00	
FlorencGjikuria									
Para: 174.528.000,00	Natyre:								
1,00									
64,00									
<p>16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit</p>	<p>Fier Fier FIER Kamion Benz TR 4048 I. Vlore Himare HIMARE Ndertim Rruga Palase-Dhermi Tirane Tirane TIRANE Furgon, Volkswagen, TR 8009 G Tirane Tirane TIRANE Mjeti Gjysmerimorkio –Marka-Iveco Fiat, Targa AB 546 NP - Tirane Tirane Tirane TIRANE Mjeti Kamion Koke Terheqese - Targa AB 656 CI Vlore Vlore VLORE Punime civile per: "Infrastruktura per pikat panoramike per gjate qarkut turistik ne Shqiperine e Jugut" 1001Vlore Orikum ORIKUM Ndertimi dhe Mirembajtja e Segmentit Rrugor Porti i Jahteve-Bypass Orikum-Dukat (Ura e Shen Elizes)", Kantieri tek pasuria me numer 352/2, Volum 7, faqe 153, Zona Kadastrale 1569, Dukat-Fushe, Vlore. Vlore Himare DHERMI Impiant i Trajtimi te Ujerave te Ndotura dhe sistemi KUZ Drimadhe, Dhermi. Tirane Petrele MULLET Fshati Dobresh, Nr.Pasurie 403/1, Zone Kadastrale Nr.1498 Fier Fier FIER Kamion Saurer TR 6752 P. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Kamion me Vinç- Iveco, AB 573 BX Fier Fier FIER Autobot Uji tip STEYR TR 9614 T. Vlore Himare PALASE Nderhyrje e integruar per permiresimin e aksesit, sherbimeve dhe rikualifikimit urban ne zonen e Plazhit Palase - Drymadhes Korce Maliq MALIQ Rikonstruksion i aksit rrugor Maliq-Lozhan i Ri-Strelcë Tirane Tirane Mjeti Gjysmerimorkio –Marka-ZORZI, Targa ALR041 - Tirane Tirane Tirane TIRANE Mjeti Autobetoniere - Scania, Targa AB 713 BX Fier Fier FIER Kamion Benz TR 9260 G. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Gjysme Rimorkio - Targa AH R690 Fier Fier FIER Autobetoniere tip IVECO FR 3385 D. Vlore Himare HIMARE Rrethi Vlore, Bashkia Himare, Mali Kolzes, "Vumblo" (Fabrike Asfalto-Betoni) Fier Fier FIER Autovinç tip IFA TR 7960 R. Fier Fier FIER Kamion Benz TR 3059 J. Tirane Tirane TIRANE Mjeti Autobetoniere - Scania, Targa AB 825 BX Fier Fier FIER Kamion Vinç Benz TR 9481 H. Tirane Tirane TIRANE Rikualifikim i</p>								



	akseve rrugore Unaza Lindore Loti 3 Fier Fier FIER Gjysem rimorkio Titan, FR 0316 D. Tirane Dajt DAJT Zall Dajt, Zona Kadastrale 3348 Tirane Tirane TIRANE Mjeti Kamioncine - Peugeot, AA 152 MB Vlore Himare DHERMI Furnizimi me uje i zonave bregdetare, Zonat e Investimit Strategjik Draleos, Drimadhes dhe Dhermi, Faza e Pare Fier Fier FIER Kamionçine Benz TR 8259 I. Vlore Himare HIMARE "Strukturë Shërbimi-Hotel me 1-6 kate dhe 7 kate mbi toke dhe 3 -7 kate nëntokë, Njësia Struktuore HI.UB.1.750, me vendndodhje Bashkia Himare".
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: GJIKURIA E-Mail: info@gjikuria.al Telefon: 042264758 Të Tjera: Depozitim i vendimit dt 27-10-2010 per: Emerimin e Z.Nikolla Geço si ekspert kontabel per hartimin e raportit per zmadhimin e kapitalit.
18. Statusi:	Aktiv

Datë: 24/04/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



A2025051400119238262

AKT MARREVESHE

Sot, më datë 24/04/2025, para meje Noter ALKET Z. MANÇKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, NR.2, ASIM ZENELI, NR.10, NR.6 :

PALET :

Gjikuria SH.P.K., një shoqëri shqiptare me përgjegësi të kufizuar, me NUIS J62903456H, me adresë në Rrugën "Faik Konica", residenca "Lion Park", kat 3-të, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht në këtë Akt nga administratori i saj, z. Florenc Gjikuria, shtetas shqiptar, lindur më 12.01.1973, në Memaliaj, i pajisur me letërnjoftim ID me numër H30112106 ("Shitësi"); dhe

Aleksandër Frangaj, shetas shqiptar, lindur në Zejmen, banues në adresën Vila. 87, "Rolling Hills", Tiranë, i pajisur me pasaportë me numër SE1903746 dhe numër personal G81004099S ("Blerësi").

Shitësi dhe Blerësi do të referohen në këtë Akt si "Pala" ose "Palët", siç mund ta kërkojë konteksti i këtij Akti.

Në mbështetje të marreveshes së Palëve pér të shitur kuotën e shoqërisë "White Roads" shpk ndermjet, Gjikuria SH.P.K, në cilësinë e shitësit, dhe z. Aleksandër Frangaj, në cilësinë e blerësit, ("Marrëveshja"), Palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët pér përbushjen e kushteve paraprake, përkatesisht këtë Akt të Transferimit të Kuotës, i cili do të shërbejë si provë e përbushjes së kushteve paraprake, dhe rrjedhimisht kalimin e pronësisë së Kuotës te Blerësi.

1.01 Përkufizime

Fjalët e përdorura në këtë Akt që fillojnë me gërmë kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë:

"**Blerësi**" do të ketë kuptimin e dhënë në hyrje të këtij Akti.

"**Data e Nënshkrimit**" do të ketë kuptimin e dhënë në hyrje të këtij Akti.

"**Ditë Pune**" ka kuptimin e një dite (përveç të Shtunës dhe të Dielës) e cila nuk është një ditë pushimi zyrtar dhe gjatë së cilës bankat janë të hapura pér veprimitari të përgjithshme në Republikën e Shqipërisë.

"**Kësti i Parë**" ka kuptimin e pagesës në ngarkesë të Blerësit, e cila duhet të kryhet në Datën e Nënshkrimit.

"**Kuotë**" ka kuptimin e kuotës së Shoqërisë në pronësi të Shitësit në datën e nënshkrimit të Marrëveshes.

"**Kusht Paraprak**" ka kuptimin e tërësisë së kushteve të parashikuara nga Marrëveshja, në ngarkim të Blerësit dhe Shitësit, përbushja e të cilave kushtëzon detyrimet e Palëve pér të përbyllur transaksionet e parashikuara nga Marrëveshja.







A2025051400119238262

“Ligj i Zbatueshëm” ka kuptimin e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

“Marrëveshje” do të ketë kuptimin e dhënë në hyrje të këtij Akti.

“Mosmarrëveshje” ka kuptimin e çdo mosmarrëveshjeje, debati, ose pretendimi që rrjedh nga ose lidhet me kötë Akt, ndërmjet Palëve, duke përfshirë çdo çështje lidhur me ekzistencën, vleshmérinë, interpretimin, zbatimin, shkeljen ose përfundimin e saj.

“QKB” ka kuptimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

“Shitësi” do të ketë kuptimin e dhënë në hyrje të këtij Akti.

“Shoqëri” ka kuptimin e White Roads Hotel Sh.P.K., ortak i vetëm dhe zotëruar i 100% të kuotave të kapitalit themeltar të së cilës është Shitësi, i cili ka nënshkruar Marrëveshjen me Blerësin për shitjen e të gjithë Kuotës që zotëron në Shoqëri.

1.02 Interpretimi

(a) Çdo e drejtë, detyrim, apo kusht i përshkruar në këtë Akt duhet të interpretohet në kontekstin e Aktit të marrë si e tërë duke marrë në konsideratë qëllimet që nxitin Palët për të hyrë në këtë Akt. Titujt e paragrafëve dhe nënparagrafëve që përban ky Akt janë vetëm për referencë dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin apo interpretimin e këtij Akti. Të gjitha anekset dhe shtojcat bashkëngjitur apo referuar, janë inkorporuar dhe bëjnë pjesë në këtë Akt. Nëse një fjalë e përdorur në ndonjë aneks apo shtojcë fillon me gërmë kapitale por nuk është e përkufizuar në këtë aneks apo shtojcë, do të ketë kuptimin e përkufizuar në këtë Akt.

Përveçse në rastet kur thuhet shprehimisht ndryshe, në këtë Akt:

- (i) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;
- (ii) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;
- (iii) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkates.

1.03 Objekti i Aktit

Objekti i këtij Akti është kalimi i pronesise nga Shitësi te Blerësi të Kuotës që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit total të Shoqërisë, në përputhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në Marrëveshje.

1.04 Çmimi i Blerjes së Kuotës

Çmimi i Blerjes së Kuotës është dakordësuar ndërmjet Palëve në Marrëveshje.


1.05 Plotësimi i Kushteve Paraprake

Palët konfirmojnë se të gjitha Kushtet Paraprake të parashikuara prej tyre si kusht për trasferimin e pronesise së Kuotës nga Shitësi tek Blerësi, janë plotesuar në përputhje me dakortësinë mes tyre.

1.06 Transferimi i Kuotës

Pronësia mbi Kuotën transferohet në Datën e Nëshkrimit të këtij Akti i Transferimit të Kuotës.







A2025051400119238262

1.07 Regjistrimi i Transferimit të Kuotës

Jo më vonë se 5 (pesë) Ditë Pune pas nënshkrimit të Aktit të Transferimit të Kuotës nga Palët, Shitësi dhe/ose Shoqëria duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme dhe të detyrueshme sipas Ligjit të Zbatueshëm për të siguruar regjistrimin e transferimit të kuotës së tij tek Blerësi, së bashku me dokumentet e nevojshme për këtë regjistrim tek QKB. Shitësi do të jetë përgjegjës pér korrigimin e çdo gabimi të kryer në procesin e regjistrimit. Shitësi do të njoftojë Blerësin me shkrim menjëherë pasi transferimi të jetë regjistruar në mënyrë të rregullt dhe kuota të reflektohet në pronësi të Blerësit.

1.08 Ligji i Zbatueshëm

Ky Akt dhe marrëdhënia ndërmjet Palëve do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

1.09 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët bien dakord të bëjnë përpjekje me mirëbesim për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje, debat, ose pretendim që rrjedh nga ose lidhet me këtë Akt, duke përfshirë çdo çështje lidhur me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin, zbatimin, shkeljen ose përfundimin e saj, përmes negociatave me mirëbesim.

Nëse Palët nuk arrijnë të zgjidhin Mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e fillimit të negociatave, secila Palë mund ta referojë çështjen për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm, Tiranë, në përputhje me nenin 10.01 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të Marrëveshjes.

1.10 Të Ndryshme

Gjuha dhe Kopjet. Ky Akt është hartuar në gjuhën shqipe dhe është nënshkruar dhe ekzekutuar në 2 (dy) kopje. Të gjitha kopjet kanë të njëjtën fuqi dhe efekt ligjor.

Kjo Akt u hartua në gjuhën shqipe jashtë zyres te noterit në 4 kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të Palëve. Unë Noteri, verifikova identitetin e tyre nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET

SHOQERIA GJIKURIA SHPK

(perfaqesuar nga Florenc Gjikuria)



NOTER
ALKET Z. MANÇKA

ALEKSANDËR FRANGAJ

